

VENDIM
Nr. 29 datë 15.2.2017

**MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KOMP ENERGJI” SH.P.K., ME
NUMËR 253, SERIA T14P, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE NR.102, DATË 7.11.2014, PËR TREGTIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, pika 1 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr. 840, datë 11.6.2008 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, të bordit të ERE; nenit 8, të Kontratës Koncesionare, nr. 2807 Rep, dhe nr. 371 Kol, datë 1.9.2009; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me modifikimin e licencës së aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë Komp Energji sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Komp Energji” sh.p.k. ka kryer pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin “A” të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si dhe pagesën e rregullimit për vitin 2015 dhe rezultoi i çliruar nga çdo lloj detyrimi financiar ndaj ERE-s.

- Shoqëria “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 9 (Formati dhe dokumentacioni për aplikim) të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e tregtimit të energjisë elektrike, me numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 102, datë 7.11.2014, duke zëvendësuar emrin e shoqërisë së licencuar “Komp Energji” sh.p.k., me shoqërinë “Hidropowerplant Construction” sh.p.k.

2. Të njoftohet shoqëria “Komp Energji” sh.p.k., që të depozitojë në ERE, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, licencën e tregtimit, me numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr.102, datë 7.11.2014.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti